

# Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

## Maj 2021

**Tiranë, më 23 Qershor 2021:** Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Maj 2021, janë 605.421. Krahasuar me Maj 2020, ky tregues rezulton me një rritje 13,0 herë. Në Maj 2021, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 328.742. Krahasuar me Maj 2020, ky numër është rritur me 20,1 herë.


*Ndryshimet e treguesve të lëvizjes së shtetasve, janë ndikuar nga masat kufizuese në Lëvizjen e shtetasve të vendosura në muajin Maj 2020.*

## Hyrjet e shtetasve

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri gjatë pesëmujorit të parë të 2021 është 1.083.538, duke u rritur me 1,8 herë, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020 (tab.1).

Gjatë pesëmujorit të parë të 2021, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka pasur rritjen më të madhe me 4,5 herë dhe Zvicra me 3,2 herë, ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Greqia me 68,9 % dhe Anglia me 36,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 (tab.2).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Për publikim 23/06/2021

### Daljet e shtetasve

Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Maj 2021, janë 651.062 duke shënuar një rritje me 14,4 herë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Maj 2021, janë 344.500. Krahasuar me Maj 2020, ky numër është rritur me 12,1 herë. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Maj 2021, janë 306.562. Krahasuar me Maj 2020, ky numër është rritur me 18,1 herë.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë pesëmuajorit të parë të 2021, është 1.331.373. Ky tregues është rritur me 16,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab1).

**Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj**

Periudha	Maj 2019	Maj 2020	Maj 2021	Janar-Maj 2019	Janar-Maj 2020	Janar-Maj 2021
<b>Hyrje gjithsej</b>	<b>829.164</b>	<b>46.488</b>	<b>605.421</b>	<b>3.521.042</b>	<b>1.654.711</b>	<b>2.232.505</b>
Shqiptarë	427.633	30.099	276.679	2.014.424	1.052.411	1.148.967
Të Huaj	401.531	16.389	328.742	1.506.618	602.300	1.083.538
<b>Dalje gjithsej</b>	<b>880.689</b>	<b>45.367</b>	<b>651.062</b>	<b>3.717.129</b>	<b>1.836.644</b>	<b>2.336.723</b>
Shqiptarë	477.282	28.431	344.500	2.196.873	1.139.359	1.331.373
Të Huaj	403.407	16.936	306.562	1.520.256	697.285	1.005.350

*Të dhënat janë ndikuar nga masat e pandemisë të vendosura në muajin Maj 2020.*

**Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj**

Shtetet	Maj 2019	Maj 2020	Maj 2021	Janar-Maj 2019	Janar-Maj 2020	Janar-Maj 2021
Kosovë	78.878	6.457	143.970	395.099	188.645	525.359
Maqedonia e Veriut	50.359	3.124	46.192	209.220	93.305	166.578
Greqi	41.428	779	7.578	205.612	89.732	27.928
Itali	29.257	242	17.211	117.671	44.593	60.812
Angli	11.375	98	3.440	32.130	14.619	9.238
Mali i zi	36.884	2.202	33.752	152.369	74.450	123.512
Poloni	7.837	62	4.701	13.065	1.431	6.407
SHBA	10.689	61	5.835	31.053	8.732	14.680
Spanjë	2.454	8	470	5.627	1.140	1.328
Gjermani	18.042	35	7.644	39.440	11.243	18.113
Zvicër	4.248	19	3.955	13.778	3.253	10.465
Të tjera	110.080	3.302	53.994	291.554	71.157	119.118
<b>Gjithsej</b>	<b>401.531</b>	<b>16.389</b>	<b>328.742</b>	<b>1.506.618</b>	<b>602.300</b>	<b>1.083.538</b>

*Të dhënat janë ndikuar nga masat e pandemisë të vendosura në muajin Maj 2020.*

**Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**

Periudha	Maj 2019	Maj 2020	Maj 2021	Janar-Maj 2019	Janar-Maj 2020	Janar-Maj 2021
Hyrje Shtetas të Huaj	401.531	16.389	328.742	1.506.618	602.300	1.083.538
I. Personale	392.098	5.498	327.682	1.468.275	560.312	1.050.040
1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor, etj.	376.308	4.702	318.412	1.401.057	534.172	1.004.426
2. Qëllime fetare	139	0	235	402	90	360
3. Udhëtarë transit	15.651	796	9.035	66.816	26.050	45.254
II. Biznes dhe profesionale	9.433	10.891	1.060	38.343	41.988	33.498

*Të dhënat janë ndikuar nga masat e pandemisë të vendosura në muajin Maj 2020.*

**Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit**

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Maj 2019	125.740	61.735	641.689	124.495	58.390	697.804
Maj 2020	4.978	5.780	35.730	2.104	4.096	39.167
Maj 2021	78.767	22.949	503.705	72.483	19.403	559.176
Janar-Maj 2019	543.193	177.351	2.800.498	551.415	202.799	2.962.915
Janar-Maj 2020	259.057	68.887	1.326.767	270.872	84.425	1.481.347
Janar-Maj 2021	242.437	93.084	1.896.984	250.586	88.023	1.998.114

*Të dhënat janë ndikuar nga masat e pandemisë të vendosura në muajin Maj 2020.*

# Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

## Përkufizime

**Hyrjet:** Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

**Daljet:** Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

**Vizitor:** Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

*Qëllime personale* të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor etj.;
2. Qëllime fetare;
3. Udhëtarë tranzit.

*Kategoria e biznesit* që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: [http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika\\_e\\_Revizionimit\\_Statistikor](http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika_e_Revizionimit_Statistikor).

**Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:**

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistrojnë shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarohen shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.